



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

PROJEKT – VENDIM - r. 11


“Për mbajtjen e zgjedhjeve në Drithas Poshtë, Njësia Administrative Libonik”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54, gërma “k”, neni 70 “Struktura komunitare në fshat”, Rregullores “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërvëprimin e strukturave komunitare në bashki” miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 46, datë 26.06.2020, Kapitullit IV “Zgjedhjet e organeve të strukturave komunitare”, Kreu I “Përgatitja, administrimi, mbikëqyrja e zgjedhjeve” dhe Kreu II “Kandidatët për anëtarë të kryesisë apo këshillit”, të kësaj rregulloreje, Shkresës nr. 8/1 prot, datë 08.01.2024, të Prefektit të Qarkut Korçë, protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 6885/2 prot, datë 12.01.2024, i kërkoj Këshillit të Bashkisë:

1. Mbajtjen e zgjedhjeve për kujdestar fshati në Drithas Poshtë, Njësia Administrative Libonik.
2. Mbështetur në numrin e banorëve, nevojën për shërbim sa më afër komunitetit, largësinë nga Drithasi Lart dhe kërkesës së banorëve të zgjedhim një kujdestar fshati në Drithas Poshtë .
3. Të bëhet njoftimi për fillimin e procedurave për zgjedhjet, datën e mbajtjes së tyre dhe afatet për paraqitjen e kandidaturave, nëpërmjet afishimit në Njësinë Administrative Libonik dhe në ambientet e fshatit Drithas Poshtë.
4. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 45 të Rregullores “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërvëprimin e strukturave komunitare në bashki” dhe ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.
5. Mbikëqyrja e procesit të votimit të bëhet nga ana e Këshillit të Bashkisë.
6. Zyra e Gjëndjes Civile pranë Njesisë Administrative Libonik të përgatitë listat për efekt votimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Bashkisë, Njësia Administrative Libonik dhe Zyra e Gjëndjes Civile pranë Njesisë Administrative Libonik dhe Këshilli i Bashkisë
8. Kujdestari i fshatit do të ketë kompetenca të plota si Kryetarët e Fshatrave dhe do të shpërblehet sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 8/1 Prot.

Korçë, më 08.01.2024

Lënda : Lidhur me ankesën e z. Faslli Zholi

KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ

Për dijeni : Z. Faslli Zholi
(Adresa : Zyra e Partisë së Lirisë Maliq)

Të nderuar,

Në vijim të shkresës suaj nr. 6885/1 prot, datë 28.12.2023, protokolluar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë me nr. 8, datë 04.01.2024 dhe duke marrë shkas nga ankesa e z. Zholi ku pretendohet për mosregjistrim nga ana juaj e kandidatit të koalicionit B.F., z. Sokol Xhuti, për fshatin Zvezdë, kërkojmë një informacion mbi ecurinë e procesit.

Për zgjedhjet në fshatin Drithas banorët kërkojnë që Drithasi të jetë i ndarë në Drithas Lart dhe Drithas Poshtë dhe secili të ketë kryetar më vete. Sqarojmë se shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe i fshatrave pjesë e çdo njësie administrative përcaktohen me ligj. Fshati është territor kryesisht rural, me emërtim dhe kufi të përcaktuar me ligj. Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ka përcaktuar fshatin Drithas të jetë pjesë përbërëse e Njesisë Administrative Libonik dhe ekziston si një i vetëm sikurse shpreheni dhe ju.

Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve ekzistues të njësisve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomikë e socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë. Pra riorganizimi territorial kryhet për një qëllim më madhor.

Procesi i zgjedhjes së kryetarit të fshatit lidhet me mënyrën e qeverisjes brenda fshatit, pra është personi i zgjedhur që drejton dhe organizon punën e Kryesisë, mban lidhjet me bashkinë dhe përfaqëson kryesinë në marrëdhëniet me aktorët e tjerë.

Ngritja dhe funksionimi i strukturave në fshat rregullohet me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e Këshillit Bashkiak Maliq me këtë objekt. Në të gjitha përcaktimet ligjore fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

Gjithashtu, lidhur me këtë proces, ankesa depozituar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut lidhet me pretendimin për mospërfshirje të kandidatit të subjektit politik P.D.SH., z. Dashnor Shahinas.

Për sa më sipër, Prefekti i Qarkut sugjeron rishikimin e procedurës së përzgjedhjes së kryetarit të fshatit Drithas dhe mbikqyrjen e procesit nga ana e Këshillit Bashkiak si organi kompetent.

*Këshilli
08.01.2024*

